

# **Mplakja e Popullsisë**

## **Situata e të moshuarve në**

### **Shqipëri**

Bart de Brujin

Gjergji Filipi

Majlinda Nesturi


Emira Galanxhi

# Shqipëria drejt mplakjes së popullsisë


- Edhe pse vonë krahasuar me vendet e tjera Europiane, Shqipëria filloi të përjetojë efektet e moshimit të popullsisë, proces i cili karakterizohet nga:
  - Ndryshimi në strukturën e popullsisë – ku personat e moshuar 65+, kanë një përfaqësim gjithnjë e më të lart në strukturën e popullsisë gjithsej;
  - Rritja e moshës medianë të popullsisë;
  - Raporti i lartë i personave të moshuar ndaj personave të rinj.

# Struktura e popullsisë


Censusi 1979 dhe 2011




Projeksionet e popullsisë 2015 dhe 2060



# Popullsia e vjetër po rritet më shumë sesa popullsia gjithsej





# Trendi i popullsisë 65+



Popullsia 65+ u rrit nga **5% në 11%** gjatë periudhës 1989-2011.

Procesi i moshimit pritet të vazhdojë edhe në të ardhmen – **29%** në vitin 2060

# Raportet e varësisë dhe mosha medianë




# Faktorët që drejtojnë mplakjen e popullsisë

Tre janë faktorët kryesorë që ndikojnë në mplakjen e popullsisë

1. Lindshmëria
2. Vdekshmëria
3. Migracioni

# Ndryshimet në Lindshmëri dhe vdekshmëri



Ulja e lindshmërisë – numri mesatar I fëmijëve për një grua – një përqindje më e lartë e popullsisë sonë do të jetë më e vjetër


- *Nga 3,1 fëmijë për grua në 1989 – 1.7 fëmijë për grua në 2011*

Rritja e jetëgjatësisë dhe si rrjedhim efekti I kombinuar I të dy faktorëve con në plakjen e popullsisë

- *Nga 74 vjeç në 2004 në 78 vjeç në 2014*



# Migracioni




- Migracioni nuk ka impakt të drejtpërdrejtë në popullsinë 65+
- Flukset dalëse migratore prekin popullsinë e moshës 20-40 vjec – ndikojnë në plakjen e popullsisë

# Implikime në politikë-bërje

- Procesi i plakjes së popullsisë sonë do të vendosë një barrë të rëndë mbi sistemet ekzistuese të pensionit dhe kujdesit shëndetësor.
- Duke qenë se njerëzit jetojnë më gjatë, përfitime si pensioni, kujdesi shëndetësor ose mbështetja për moshën e vjetër, do të paguhet për periudha më të gjata.
- Kur popullsia përtej moshës së pensionit dyfishohet dhe njëkohësisht popullsia në moshë pune që ofron fonde për sistemin e sigurimeve shoqërore zvogëlohet, sistemi bëhet i paqëndrueshëm dhe ka nevojë për transformime strukturore.
- Jetëgjatësia në rritje gjithashtu rezulton në kosto mjekësore në rritje dhe kërkesa në rritje për shërbime shëndetësore, sepse të moshuarit janë më të rrezikuar ndaj sëmundjeve kronike.



# NJËSIA EKONOMIKE FAMILJARE DHE KUSHTET E JETESËS

# Madhësia e NJEF



- Popullsia e moshuar jeton kryesisht **ne NJEF me 2 persona (30%)**.
- Përqindja e **të moshuarve** që jeton **vetëm** është rritur pak në terma relative (7.6% në 2011 krahasuar me 7.2% në 2001), por është pothuajse dyfishuar nëse flasim në terma absolut **16.8 mijë në 24.3 mijë** në të njëjtën periudhë.
- Ndër të moshuarit që jetojnë vetëm **77%** e tyre janë **femra**

# Gjendja martesore




- Popullsia 65+ karakterizohet nga një status martesor – **“Të martuar” dhe “Të ve”**
- 48% e femrave 65+ janë të veja dhe vetëm 11% e meshkujve janë të ve.

# Kushtet e jetesës

- Referuar kushteve të banimit – përqindja e popullsisë 65+ që ju mungonte **rrjeti i ujësjellësit brenda banesës u ul nga 53% në 2001 në 35% në 2011.**
- Përqindja e tyre pa WC me ujë të rrjedhshëm brenda në banesë u **reduktua nga 45% në 24% midis 2 censuseve të fundit.**
- Pajisjet afatgjata – rritje e përqindjes së popullsisë 65+ të cilët kanë lavatrice, frigorifer, TV, makina, mikrovalë dhe kondicioner.
- Megjithatë përqindje e ulët e popullsisë 65+ zotërojnë mjetet moderne të komunikimit si: kompjuter (15%) dhe internet (9%).
- **83% e popullsisë 65+ zotërojnë një celular.**

# SHËNDETI


# Perceptimi i shëndetit



- Studimi nga Shoqata Shqiptare e Geriatriisë dhe Gerontologjisë në vitin 2007-08 tregon se rreth 32 përqind e të moshuarve vlerësojnë veten të pashëndetshëm dhe 10 përqind me shëndet të keq



# Aftësia e kufizuar



- 23% e popullsisë 65+ raportojnë të jenë me aftësi të kufizuar, janë **femrat** ato që shënojnë një përqindje më të lartë
- Vështirësitë në **lëvizje** shënojnë vlerën më të lartë

# PUNËSIMI

# Të moshuarit në punë


- **10 përqind e personave 65+** janë akoma të përfshirë në punë. Edhe pse disa prej tyre mund të punojnë nga dëshira për të qenë aktivë, shumë të tjerë janë të detyruar të punojnë nga pamjaftueshmëria ose mungesa e pagesës së pensionit
- Sektori ekonomik ku shumica e të moshuarve janë aktivë është **bujqësia**
- Krahasuar me popullsinë në moshë pune, të moshuarit **punojnë më pak orë**. Më pak se gjysma (47 përqind) e të moshuarve që punojnë punojnë më pak se 30 orë në javë. Ndërkohë që janë **meshkujt** ata që kanë prirje të punojnë më shumë orë sesa gratë

# MOSHIMI AKTIV DHE VULNERABILITETI

# Indeksi i Mbikqyrjes së Moshës

- Për Shqipërinë është llogaritur Indeksi Global i Mbikëqyrjes së Moshës (përgatitur nga **HelpAge International**) është ndërtuar për matjen e cilësisë së jetës dhe mirëqenien e popullsisë së moshuar. Indeksi mbledh në tërësi **13 tregues** të krahasueshëm në nivel ndërkombëtar, bazuar në:
  - statusin e të ardhurave të personave të vjetër,
  - statusin shëndetësor,
  - aftësinë (arsimi dhe punësimi) dhe
  - mjedisin mundësues.

# Indeksi i Mbikëqyrjes së Moshës




Indeksi Global i Mbikëqyrjes së Moshës ka vendosur Shqipërinë në vendin e 53-të në botë.

Renditet më lart në fushën e mundësive (24). Ka një performance mesatare në fushën e sigurisë së të ardhurave (45).

Renditet poshtë në fushën e shëndetit (61) dhe gjendet akoma më poshtë në fushën e mjedisit mundësues (86)

# Indeksi i Vulnerabilitetit

- Qëllimi i këtij treguesi është të japë informacion për nivelin e vulnerabilitetit të të moshuarve në 61 bashki, sipas ndarjes së re administrative.
- Kjo qasje përcakton vulnerabilitetin si një koncept dinamik duke ju referuar rrezikut që do të përjetojë një i moshuar:
  1. që jeton vetë, ose
  2. që jeton në shtëpi pleqsh, ose
  3. që ka të paktën një aftësi të kufizuar (dëgjimin, shikimin ose lëvizjen), ose
  4. që ka burim të ardhurash ndihmën sociale, remitancat ose të ardhura të një personi tjetër.



Indeksi i vulnerabilitetit të personave **65 vjeç e lart është 1.14.**

Vlera maksimale e tij vërehet në bashkinë e **Kukësit** (1.34), ndërsa vlera minimale në bashkinë e **Finiqit** (0.99).

Nga 61 bashki, 35 prej tyre kanë indeks vulnerabiliteti më të lartë se mesatarja e vendit (1.14).



# Gjetjet kryesore – Mplakja e popullsisë

- Rritja e numrit të popullsisë 65+ pritet të vazhdojë edhe në dekadat e ardhshme
- Ulja e lindshmërisë dhe rritja e jetëgjatësisë do të jenë faktorët kryesorë që do të nxisin plakjen e popullsisë
- Rritja e numrit të të moshuarve do të ndikojë rëndësishëm jo vetëm statistikat demografike por gjithashtu do të jetë një faktor i rëndësishëm social dhe ekonomik me nevoja dhe kërkesa specifike
- 23% e të moshuarve vuajnë nga një aftësi e kufizuar dhe shumica e tyre deklarojnë se vuajnë nga një sëmundje kronike
- Një pjesë më e madhe e të moshuarve jetojnë në NJEF me 2 anëtarë, pa praninë e personave më të rinj
- Një pjesë e vogël e të moshuarve janë ende aktiv, pjesë e forcës së punës
- Të moshuarit më vulnerabël janë të përqëndruar në veri-lindje të vendit

**FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN  
TUAJ!**